



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTRI

Nr 12613/1

25/10/2011

UDHËZIM

Nr 23, datë 25/10 2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR 25 DATË 30.11.2007 "PËR  
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E  
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË  
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË  
KËMBIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave" Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", me propozimin e Komisionit *Ad-Hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 13 e Udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

"13. Vlera e një autoveture do të gjendet në tabelë ("QUATTRORROUTE") duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit të gjendur në tabelë".

2. Pika 15 e Udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

"15. Kur për autoveturën që vlerësohet në buletin nuk gjendet modeli, vlerësimi të bëhet duke u nisur nga modeli dhe cilindrata më e afërt. Në këtë rast vlera nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që jepet në tabelë".

3. Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
Ridvan Bode

